



REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
 Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo
 Ministria e Financave / Ministarstvo Finansija / Ministry of Finance
 Ministria e Punëve të Brendshme / Ministarstvo Unutrašnjih Poslova / Ministry of Internal Affairs
 Departamenti i Ankesave
 Prot. 477/22 Data 30/11/2022
 PRISHTINË



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo
 Qeveria e Kosovës - Vlada Kosova - Government of Kosovo
 Ministria e Financave, Punëve të Brendshme dhe Transportit - Ministarstvo Finansija, Radni i Transporta -
 Ministry of Finance, Labour and Transport
 Administrata Takimore e Kosovës - Poreska Administracija Kosova - Tax Administration of Kosovo



ADMINISTRATA TATIMORE E KOSOVËS (ATK) - Divizioni i Ankesave (DA-ve) në përbërje të panelit shqyrtues: Emine Nikqi kryesues, Xhevdet Neziri anëtar dhe Seide Berisha anëtare, duke vendosur në çështjen administrative tatimore, sipas ankesës së subjektit në procedurë nga [redacted] SH.P.K. me NUI [redacted], me adresë Agim Meka, PN Pejë, me pronar dhe Shkëlzen Mekaj me ID. [redacted], ankesa e dorëzuar në Administratën Tatimore të Kosovës në Divizionin e Ankesave me dt.16/11/2022, dhe protokolluar me nr.477/2022, kundër Njoftim Rivlerësimeve për Tatimin shtesë, të lëshuara nga Drejtoria Rajonale në Pejë, në mbështetje të nenit 77 të Ligjit Nr. 03/L-222 mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat, mori këtë:

VENDIM

I. Refuzohet si e pa bazuar ankesa nr. [redacted] të datës 16/11/2022, e tatimpaguesit [redacted] SH.P.K. me NUI [redacted], me adresë [redacted] N Pejë, me pronar dhe [redacted] mbështetje të nenit 132, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 05/L-031 "Për Procedurën Administrative" në lidhje me paragrafin 2 të nenit 89 të Ligjit Nr. 03/L-222 "Për Administratën Tatimore dhe Procedurat" dhe Njoftim Rivlerësimit e tatimit shtesë për periudhat e kontrollit vërtetohen si të bazuara.

II Njoftim Rivlerësimit e tatimit shtesë nga periudha 01/2021 deri më 08/2022 në llojin e tatimit "WR" sipas Raportit të kontrollit datë: 13/10/2022 [redacted] me NUI [redacted], vërtetohen si të bazuara.

III. Procedura e ankesës nuk ndërprejnë obligimin e tatimpaguesit për pagesë të detyrimeve tatimore (tatim, ndëshkime dhe interes) në përputhje me nenin 9, paragrafin 1, të Ligjit Nr. 04/L-102 për Ndryshim Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat.

Arsyetim

Tatimpaguesi ka dorëzuar ankesë në Divizionin e Ankesave më datë 11/11/2022, në Drejtorinë Rajonale në Pejë, ndërsa në Divizionin e Ankesave është protokolluar me datën 16/11/2022 ndërkohë Njoftim Rivlerësimit nga Kontrolli dhe Procedurën e ankesës e ka pranuar më datë 13/10/2022 gjë që ankesa është parashtruar në afatin ligjor prej 30 ditësh e përcaktuar me nenin 77.2 të Ligjit Nr. 03/L-222 "Mbi Administratën dhe Procedurat Tatimore".

Historia e biznesit "[redacted] SH.P.K. me NUI [redacted], me adresë Agim Meka, [redacted], me pronar dhe [redacted] me [redacted] Veprimtaria Prodhimi i produkteve të tjera metalike p.k.t. i regjistruar me 19/06/2019.

Kontrolli ka filluar më datën 21/09/2022 sipas formës AU001 dhe AU002. Ndërsa AU003 Dokumenti i kërkesës së informatave është dorëzuar 03/10/2022 tatimpaguesit. Objekti ku posedon zyrën tatimpaguesi është me qira mujore nga 450€ ne muaj neto ku ceket periudha kohore 3 vite duke filluar nga 01/09/2019.

Statusi Ligjor biznesit Shoqëri më përgjegjësi të kufizuar, (SH.P.K.) drejtor i biznesit është [redacted] Nr. letër nj. [redacted] i cili është aksionar i vetëm 100%

Periudha 2021 Duke u bazuar ne Ligjin 03/L-222 neni 14 dhe neni 19 paragrafi 2 kemi bere vlerësimin dhe jemi bazuar ne te gjitha provat, qe kane qene ne dispozicion. Ne mbështetje te kontratës me Akt Noterial Nr. referencë 2933/2022 ne nenin 5 paragrafi 5.2 qiradhënësi me datën 01/01/2021 këtë patundshmëria ia ka lëshuar dhe dorëzuar në Shfrytëzim te lire dhe te pa penduar nga ai, dhe nga personat e tret, ku Tatimi ne qira llogaritet nga data qe e ka ne shfrytëzim - dispozicion. Tatimi ne qira llogaritet për periudhën 01/2021-deri ne 12/2021 dhe ka obligime tatimore ne vlerë prej 355.312€ .Ndërsa ne periudhën 01/2022 deri me 08/2022 për tatimin ne qira ka obligime tatimore vlerën 236.88€

Ankesë-Tatimpaguesi në ankesën e dorëzuar me shkrim konteston Raportin e Kontrollit veprimtaria primare është: Prodhimi i produkteve të tjera metalike p.k.t. Raporti i Kontrolli është datës 13/10/2022 nr. i Dosjes 13644 të lëshuar nga Administrata e Kosovës Regjioni Pejë paraqet vlerësim të gabuar të obligimit shtesë për Llojin e tatimit "WR" në vlerë prej 592.20€, ndeshkim 181.82€, interes 43.70€ dhe Zgjona 500€ nga periudha 01/21-08/22. Provë materiale i bashkëngjitet kontrata e motorizuar ku neni 4, pika 4.1 e specifikon mirë datën e hyrjes ne obligime për tatim në qira. Kompania ka qene e mbyllur më Raport të kontrollit datë 25/08/2022 nr. i Dosjes 13201 nga i njëjti Inspektor dhe nuk ka gjetje te obligimeve shtesë për "WR". Inspektori bën shkelje të procedurës administrative duke ju kthyer mbrapa Raportit te kontrollit dhe e ka mbylle vet pa u kthyer lënda ne ri kontroll, Inspektori kur bën thyerjen debi 'kredi të obligimeve shtese me TVSH-në e rimbursur bën thyerje me tatime te paguara për muajin 08/2022 si janë WR paguar me 15/09/2022, ndërsa afati i fundit për pagese ka qene data 17/09/2022 për shkak ditëve të pushimit, prove materiale parapagimi ne pasqyrën e tatimpaguesit, dhe dëshmitë e pagesës. Pra nga faktet e prezantuar kërkojmë nga ATK Departamenti i Ankesave të hedhë poshtë obligimin shtese 'WR' te kontrolli është, sepse pretendimet [redacted] e janë të ngutshme dhe të pa bazuara në fakte dhe të njëanshme dhe të pa vlerësuar në mënyrë të duhur.

Divizioni i Ankesave pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit në lëndë, pretendimeve në ankesë, vendos se: Ankesa e Tatimpaguesit është e pabazuar .

Dispozitivi i këtij Vendimi të Divizionit të Ankesave mbështetet ne faktet ne vijim:

Divizioni i Ankesave me pëlqimin e palës nuk ka organizuar seancë dëgjimore duke u bazuar ne nenin 96 te Ligjit për Procedurën Administrative Nr.05/L- 03 l.

Administrata Tatimore e Kosovës-Divizioni i Ankesave pas shqyrtimit dhe pretendimeve në ankesës, administrimit dhe vlerësimit të gjitha provave në shkresat e lëndës dhe provave të ofruara nga tatimpaguesi, paneli shqyrtues vlerësoi se ankesa e subjektit në procedurë është e pa bazuar.

Divizioni i Ankesave konstaton se kontrolli, këtë vendosje - vlerësimin e ka mbështet në nenin 14; 15 dhe 19 të Ligjit Nr. 03/L-222 mbi Administratën Tatimore dhe procedurat ku paragrafi 2 i nenit 19 të ligjit nr. 03-L/222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, parasheh: Vlerësimi i Drejtorit të Përgjithshëm do të bëhet sipas gjykimit të tij ose saj më të mirë dhe do të bazohet në të gjitha provat që ai ose ajo ka në dispozicion. Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, divizioni i ankesave në procedurën e provave, njoftim vlerësimet dhe fletat të punës së kontrollit, deklaratimet e tatimpaguesit, të dhënë nga tatimpaguesi dokumentet e ofruara nga tatimpaguesi me ankesë, dhe pretendimeve ankimore; nga të njëjtat DA-ja nxjerr konstatimin se: ATK-DR-Pejë, ka kryer kontrollin tatimor tek subjekti [redacted] dhe NU [redacted], në këto llojet të tatimeve si: TVSH, WM ,CM ,WR, për periudhën 01/2021-08/2022

Divizioni i Ankesave konstaton se pretendimi i tatimpaguesit se biznesi është ngarkuar me tatim shtesë në llojin e Tatimit "WR" periudhën 01/2021-08/2022 paraqet vlerësim të gabuar të obligimit shtesë për Llojin e tatimit "WR" në vlerë prej 592.20€, ndeshkim 181.82€, interes 43.70€ dhe Zgjidhje 500€ për vitin 01/21-12/21 deri me 01/22-08/22. Duke u bazuar në kontratën e qirasë me nr. 2933/2022 se në këtë ngastër [redacted] në sipërfaqe [redacted] e ndodhur në fsh. [redacted] duke qenë se në këtë ngastër janë duke u bërë investime dhe pavarësisht nga fakti se a kryhen punimet apo jo tatimin në burim do të mbahet nga periudha 01/06/2023.

Divizioni i Ankesave bazuar në shkresat në lëndë dhe informata nga tatimpaguesi nuk mund të provohet se tatimpaguesi për qiranë të padeklaruar ka vepruar komfor dispozitave ligjore që e rregullojnë çështjen në fjalë. Divizioni i ankesave konstaton se tatimpaguesi me rastin e angazhimit të tij si aksionarë në kryerjen e punëve si drejtor menaxhues bazuar në deklaratimet e vet tatimpaguesit, tatimpaguesit është dashur që për transaksionin në fjalë qiramarrës dhe qiradhënës (duke pasur parasysh se tek shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar drejtori është i ndarë nga entiteti), të përcaktojë dhe deklarojë qiranë sipas vlerës së hapur të tregut komfor nenit 46 të ligjit nr. 03/L-222 dhe mbi bazën e kësaj qiraje të deklarojë për tatim në komfor nenit 31 të ligjit nr. 06/L-105. paragrafi 3. Andaj, tatimpaguesi duke mos ju përmbajtur dispozitave të lartë cekura nuk ka plotësuar kriteret për ta liruar tatimpaguesin nga obligimi tatimor për qira, periudha 01/2021-08/2022. DA-ja konstaton se tatimpaguesi nuk ka argumentuar të kundërtën e vlerësimit zyrtar të ATK-së sipë parashih nenin 19, paragrafi 6 i Ligjit nr.03/L-222, dispozitë që parashih: "tatimpaguesi ka barrën e provës lidhur me të provuarit se kryerja e ndonjë vlerësimi nga Drejtori i Përgjithshëm është e gabuar dhe barrën për të provuar se shumica e ndonjë vlerësimi të tillë është e pasaktë"

Andaj, Divizioni i Ankesave vlerëson se pretendimet e tatimpaguesit në ankesë, nuk paraqesin argumente të mjaftueshëm dhe esenciale për të ndryshuar. Njoftim Rivlerësimet e tatimit shtesë caktuara nga ATK-Drejtoria Rajonale në Pejë, në llojin e tatimit "WR" periudha 01/2021-08/2022 mbasin sipas vlerësimit të kontrollit dhe vërtetohen si të bazuara.

Nga arsyet e theksuar më lartë është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi bazuar në nenin 77.2 të Ligjit Nr. 03/L-222, "Për Administratën Tatimore dhe Procedurat", duke pasur parasysh kontestin dhe të gjitha provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, në përputhje me nenin 132, pika (2), të Ligjit për Procedurën Administrative Nr.05/L- 031, Divizioni i Ankesave e vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi bazuar në nenin 3 të Ligjit Nr. 04/L-102 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-222 "Për Administratën Tatimore dhe Procedurat", tatimpaguesi i pa kënaqur ka të drejtën që brenda afatit tridhjetë (30) ditësh, nga dita e pranimit të Vendimit të Divizionit të Ankesave, ta kundërshtojë këtë vendim në Divizionin Fiskal të Divizionit Administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë.

DIVIZIONI I ANKESAVE NË PRISHTINË
Nr.477/2022 datë 30/11/2022

Vendimi t'iu dorëzohet:

1. Tatimpaguesit
2. Administratës Tatimore

Udhëheqësi i Divizionit të Ankesave
Skender Krasniqi
Kryesuesi i panelit
Emine Nikçi

